



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.08

Prishtinë, më 18.03.2015, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-303

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi, Salih Morina, Shpejtim Bulliqi, Shukrije Bytyqi dhe Teuta Haxhiu.

Munguan: Mufera Sinik dhe Jelena Bontiq.

Pjesëmarrës i ftuar: Arsim Bajrami, Ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë.

Pjesëmarrës të tjerë: Florina Merovci – zyra e Presidentes, Petrit Hysaj-OSBE-së, Lirije Palushi dhe Lirika Demiri- organizata CPC, Blendina Krasniqi-UNDP (praktikante), Driton Selmanaj dhe Jetmir Bakija- KDI, Përparim Bublaku- Lajmi.net, dhe zyrtarë për media të Kuvendit.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky rend dite:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.03.2015;
3. Diskutim lidhur me gjendjen në Arsimin e Lartë, i ftuar Arsim Bajrami, Ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë;
4. Të ndryshme.

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 11.03.2015

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 11.03.2015, u miratua pa vërejtje.

3. Diskutim lidhur me gjendjen në Arsimin e Lartë

Nait Hasani, tha se kemi të ftuar Ministrin e Arsimit për të diskutuar më gjerësisht për gjendjen në Arsimin e Lartë meqë ditëve të fundit kanë dalë afera të ndryshme për sa i përket çështjes së regjistrimeve dhe diplomave false.

Arsim Bajrami, ministër i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, tha se prioritet i Qeverisë është ngritja e cilësisë në arsim në të gjitha nivelet sepse niveli i arsimit në Kosovë ende është larg standardeve ndërkombëtare. Ai tha se jemi në proces të diskutimit të Ligjit për Arsimin e Lartë si dhe Ligjin për Profesione e Rregulluara, me qëllim të vendosjes së standardeve të profesionit në bazë të direktivës së Bashkimit Evropian. Ai tha se kanë kërkuar nga Agjencia e Akreditimit një pasqyrë të Institucioneve të pa licencuara, që janë duke vepruar në Kosovë duke përfshirë të ashtuquajturin Universiteti i Paqes, i cili konsiderohet i paligjshëm. Në vazhdim ai tha se lajmi për 505 diploma false në Pejë është i pavërtetë dhe se bëhet fjalë për regjistrime jashtë kriterit të konkursit, përtej normës. Kjo ka ndodhur në vitin 1999 dhe në këtë periudhë ka pasur probleme të mëdha me çështjen e dosjeve të djegura gjatë luftës, tha se ka urdhëruar inspektim special në këtë rast, duke angazhuar më shumë se 10 inspektor të Pejës, Gjakovës dhe Prishtinës. Deri me tani nga 205 lëndë të shqyrtuara ka dalë se 125 raste janë të padiplomuar, për 21 raste nuk janë të kompletuara dosjet, ndërsa 17 raste janë të diplomuar dhe diplomat e tyre janë valide. Ai theksoi se do të fokusohemi në inspektimin e të gjithë bartësve privat të arsimit të lartë, që nga stafi i profesorëve dhe asistentëve që angazhohet dhe përmes këtij inspektimi do të vendosim rend dhe rregull.

Nait Hasani, pyeti se pse inspektorati i arsimit nuk ka marrë asnjë masë për çështjen e diplomave para se të bëhen publike, shkolla e policisë në Vushtrri a duhet të licencohet, dhe si do të funksionalizohet digjitalizimi i provimit të maturës, a do të ketë ndonjë defekt tjetër. Ai tha se për themelimin e ECPD-së ka nënshkruar ministri Ramë Buja, ish rektori Enver Hasani dhe Hajredin Kuqi dhe çka do të bëhet me 20 studentët që kanë doktoruar nga buxheti i Kosovës në këtë Universitet. Në vazhdim tha se kam të dhëna se një shkollë e mesme private në Prizren e quajtur Loyola, financohet nga buxheti i Kosovës.

Arsim Bajrami, tha se për ECPD-në do të jem i pakompromis dhe do ta udhëzojë këtë Institucion që nëse do ndonjëherë të bëhet Universitet të fillojë nga pika zero dhe studentët që kanë doktoruar aty duhet të ballafaqohen me pasojat sepse kur një kandidat të shkojë në doktoraturë duhet të shikojë se a është i ligjshëm apo jo ai Institucion. Sa i përket inspektoratit tha se do të jetë ligji për inspektoratin e arsimit së shpejti në Kuvend dhe se është e vërtetë që inspektorati ka qenë pasiv edhe besojë që tash do të shihni një inspektim më proaktiv të

inspektoratit më larg mediave dhe më të funksionalizuar. Ai tha se digjitalizimi i maturës është i paraparë me ligjin e ri, është projekt madhor dhe që nuk e ka implelementuar asnjë shtet në rajon dhe sa i përket shkollës në Vushtrri, tha se është një institucion i arsimit të lartë që po ofron studime bachelor dhe në bazë të ligjit për arsimin e lartë edhe kjo shkollë është e detyruar të ndjek procedurën e licencimit dhe akreditimit. Në vazhdim tha se Loyola është fryt i bashkëpunimit të mirë në mes të Qeverisë Gjermane dhe Qeverisë së Kosovës, toka është siguruar nga komuna e Prizrenit, ndërtimi i shkollës është bërë nga Qeveria Gjermane dhe Qeveria e Kosovës ka marrë për obligim ti paguaj mësuesit, ai tha se ky është ndër gjimnazet më të mirët në Kosovë dhe në takimin me Ministrin e Arsimit të Gjermanisë do të kërkoj që kjo shkollë ti ipet si aset Kosovës dhe të kaloj në shkollë publike të Komunës së Prizrenit.

Salih Morina, pyeti se cilët do të jenë hapat konkret që ju si Ministër do ti ndërmerri pasi që nuk kemi të bëjmë me 505 diploma false por me 505 student të regjistruar në mënyrë të parregullt, që nënkuptohet prapë si shkelje nga menaxhmenti i atij Universiteti dhe pyeti se a ka inspektor të mjaftueshëm për fusha të caktuara dhe çfarë masa do të ndërmerri për inspektorët që nuk e kanë kryer punën si duhet.

Teuta Haxhiu, pyeti se a e keni parë ju marrëveshjen për ECPD-në, të nënshkruar nga ish ministri Ramë Buja, Hajredin Kuqi dhe Enver Hasani, pasi që disa herë ka kërkuar nga AKA-ja për ta parë por nuk ka marrë përgjigje. Ajo tha se gjatë vizitave nëpër Komuna kemi parë shumë mësimdhënës që janë kualifikuar nga Bartësit e Arsimit Privat, çka do të bëhet me ta duke e ditur se Ligji për Arsimin e Lartë ua ndalon këtyre bartësve të përgatitë kuadro për mësimdhënës. Ajo theksoi se shkeljet e Bartësve Privat të Arsimit të Lartë po vazhdojnë, ka student që janë regjistruar në vitin e parë të studimeve pa test të Maturës, ka ndodhë që edhe ndoshta kanë përfunduar studimet pa e kaluar testin e Maturës, çfarë do të ndodh me diplomat e atyre studenteve dhe kur do të ndërhyri në çështjen e adresave elektronike të Kolegjeve private të cilat ende i kanë me UNI si dhe bëjnë shkelje tjetër të Ligjit rreth emërimit të tyre.

Shukrije Bytyqi, përgëzoi ministrin për miratimin e Ligjit për Maturën, si dhe për anulimin e konkursin të shpallur nga Agjencioni për Arsim dhe Aftësim Profesional dhe Arsim për të Rritur i cili ka qenë politik dhe i pa ligjshëm. Ajo njoftoi se trupa e Inspektoratit të Punës në Kuadër të Punës dhe Mirëqenies Sociale, Inspektorati i Arsimit në Prishtinë, Sektori i Inspektoratit të Arsimit në Gjakovë, Inspektorati i Punës në Prizren, Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Avokati i Popullit, Agjencia për Arsim dhe Aftësim Profesional janë marrë me çështjen e arsimit në Malishevë, që nuk ka qenë e arsyeshme kur dihet se problematikat e arsimit në Kosovë janë të njëjta. Ajo tha se nuk shpresoj shumë në cilësi, kur në Agjencinë për Akreditim ka njerëz që kanë afëra korruptive dhe kur ky Agjencion nuk ka një staf të kompletuar.

Ismajl Kurteshi, theksoi se në takimin e datës 26 dhjetor 2014 me ministrin është premtuar që për takimin e radhës me Komisionin do ta prezantoni planin e punës gjë që nuk ka ndodhur. Lidhur me Universitetin e Pejës tha se është absurde që 17 studentë që janë regjistruar në mënyrë paligjshme të kenë përfunduar me diploma të ligjshme. Ai tha se Kolegjet që mbajnë mbishkrime të falsifikuara dhe bëjnë regjistrime deri në fund të semestrit të parë mund të ndalohen me një

vendim të Ministrisë sepse është shteti ai që duhet ti ndjek falsifikatorët. Në vazhdim pyeti rreth Universitetit të Mitrovicës në pjesën veriore, kush e kontrollon atë pasi që ai financohet nga Buxheti i Kosovës. Ai tha se në vazhden e këtyre falsifikimeve tha se në Universitetin e Gjilanit njëri nga punëtorët e administratës, i akuzuar për falsifikim, e ka marrë dokumentacionin me vete dhe i njëjti ka kushtëzuar kthimin e dokumentacionit me kthimin e tij në punë.

Bekim Haxhiu, pyeti se kur ka filluar të punojë ECPD-ja, sa student nga Ministria kanë marrë bursa për të studiuar në këtë Universitet dhe a do të kërkonin që këto mjete ti kthejnë. Në vazhdim shtroi çështjen e themelimit të Universitetit të Shkencave Mjekësore në Prishtinë, pasi për këtë janë pajtuar dhe kanë nënshkruar mbi 95% të stafit akademik. Sa i përket studimeve në Kolegjet private ai tha se studentëve që përfundojnë studimet Bachelor u është pamundësuar të vazhdojnë studimet Master në Universitetin e Prishtinës. Lidhur me testin e Maturës tha se deri me tani ka qenë ngarkesë e madhe që nxënësit që kanë përfunduar shkollën e mesme ti nënshtrohen tre provimeve brenda një periudhe të shkurtër, shpreson që me Ligjin e ri të eliminohet kjo ngarkesë.

Shpejtim Bulliqi, pyeti sa Institucione të Arsimit të Lartë janë të pa akredituara dhe se çfarë do të bëhet me ata njerëz që kanë Doktoruar në Universitetin e Paqes, pasi që shumica prej tyre janë duke u avancuar nëpër pozita, në vend që të përballen me Prokurorinë. Në vazhdim shtroi çështjen e ngritjes së cilësisë në arsim, dhe në këtë kontest shtroi çështjen e furnizimit të shkollave me harta zyrtare në nivel të Kosovës, lidhur me këtë tha se Ministria e Arsimit më parë e ka shpallur një tender për të blerë gjëra elementare përfshirë edhe harta për shkolla dhe më pas është anuluar.

Arsim Bajrami, tha se Diplomat që konstatohen se janë false asnjëherë nuk do të bëhen ligjore. Tha se jemi duke punuar që të krijojmë inspektor të profesionalizuar. Lidhur me çështjen e ngritur rreth nënshkrimit të marrëveshjeve me ECPD-në nga ish ministri Velu dhe Buja, në asnjërin nga këto marrëveshje nuk kanë nënshkruar Enver Hasani dhe Hajredin Kuqi dhe Ministria e Arsimit nuk ka dhënë asnjë bursë për këtë Universitet. ECPD-ja ka filluar punën në 2006, dhe ne nuk marrim përgjegjësi për studentet që kanë përfunduar Doktoraturën në këtë Institucion. Në vazhdim ai tha se Bartësit Privat të Arsimit të Lartë për ne janë Kolegje, ndërsa se si e vetëquajnë ata veten dhe çfarë vendosin ata në reklama është përgjegjësi e tyre. Rreth kredibilitetit të Agjencionit të Akreditimit, tha se është e vërtetë që ky kredibilitet pak është prekur me hetimet që po zhvillohen ndaj drejtorit të Agjencisë. Sa i përket regjistrimeve tha se është paraparë që librat Amë të mbyllen më 15 shtator në Universitetet Publike ndërsa me 15 nëntor në Kolegjet private. Sa i përket 17 diplomave të rregullta nga Universiteti i Pejës ai tha se regjistrimi ka qenë i parregullt por historia e studentit nuk është kontestuar sa i përket notave dhe një fenomen të këtillë e hasim jo shumë rrallë në Universitetet publike. Në vazhdim ai tha se asnjë diplomë e Universitetit të Mitrovicës nuk do të pranohet deri sa ky Universitet të filloi ti procedurat e licencimit dhe akreditimit. Për sa i përket themelimit të Universitetit të Shkencave Mjekësore tha se kjo çështje në fazën e parë duhet të zhvillohet brenda UP-së, pastaj duhet të zhvillohen procedurat ligjore. Ai tha se do ti krijojmë kushtet nëpër shkolla, nuk do të ketë vetëm Kosova një hartë por do të ketë edhe Diaspora.

4. Të ndryshme.

Nuk pati diskutime për këtë pikë të rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi në orën 12:00.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani